



## KOMUNA E PRISHTINËS

### RAPORT MUJOR

Drejtoria	<b>Drejtoria e Bujqësisë</b>
Periudha raportuese	<b>Qershor, 2019</b>
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Shkumbin Gashi

**1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.**

Duke u bazuar në planprogramin e punës në kuadër të Drejtorisë, brenda periudhës raportuese janë zhvilluar takime me grupet e interesit: fermerët, shoqatat e ndryshme, institucionet e ndryshme etj.

Realizimi i aktiviteteve të ndryshme në sektorin e bujqësisë që kanë qenë të planifikuara në programin e punës.

**2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj:**

- Përgatitja e kriterëve dhe udhëzuesve për projekte në sektorin e bujqësisë;
- Këshillimi i fermerëve rreth mënyrës së aplikimit për grante të financuara nga Komuna e Prishtinës;
- Fillimi i procedurave rreth përcaktimit të kriterëve për grante në sektorin e bujqësisë, projekte të financuara nga Komuna e Prishtinës;
- Përkrahje për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR ) në pranimin e aplikacioneve për subvencione;
- Takim me delegacionin e qytetit të Des Moines, IOWA, SHBA, i cili do t'a vizitojë Komunën e Prishtinës, më 24, 25 dhe 26 qershor 2019.

**3. *AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë:***

- Janë përgatitur kriteret dhe udhëzuesit për aplikim për projekte të financuara nga Komuna e Prishtinës në të gjithë sektorët e bujqësisë;
- Janë këshilluar mbi 30 fermerë për mënyrat e aplikimit për grante dhe subvencione në Komunën e Prishtinës;
- Ka përfunduar procesi i përcaktimit të kriterëve për grante në sektorin e Bujqësisë, projekte të mbështetura nga Komuna e Prishtinës;
- Është ofruar përkrahje për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), në pranimin e aplikacioneve për subvencione të financuara nga Ministria e Bujqësisë për fermerët e komunës së Prishtinës. Të gjitha aktivitetet janë zhvilluar në muajin qershor 2019 dhe kanë aplikuar 900 fermerë;
- Janë zhvilluar takime me delegacionin nga qyteti i Des Moines, IOWA, SHBA ku është biseduar rreth bashkëpunimit institucional dhe në shkëmbimin e përvojave në fusha të ndryshme të bujqësisë ndërmjet dy vendeve.

**4. *AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues:***

- Vazhdojnë vizitat për subvencione dhe grante gjatë muajit korrik në komunën e Prishtinës;
- Vazhdojnë vizitat për vlerësimin e aplikuesëve për pajisje bujqësore tek fermerët e komunës së Prishtinës;
- Vizita monitoruese te fermerët përfitues të granteve, projekte të mbështetura nga Komuna e Prishtinës dhe Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA).

**4.1.2. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese.**

- Nuk është planifikuar buxhet për këtë periudhë.

**4.1.3 Takimet me palë:**

- Janë mbajtur 72 takime me palë.

**5. Takimet me institucione të tjera:**

- Është mbajtur një takim me zyrtarët e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR).

**6. Diskutime publike / Takimet me qytetarë:**

- Nuk ka pasur diskutime publike.

**6.1.1 Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare:**

- Nuk ka pasur kërkesa të tilla.

**6.1.2. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër:**

**7. Takime të tjera**

- Nuk ka pasur takime të tjera.

**8. SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh.: pengesa brenda Drejtorisë, Komunës, apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.**

**9. REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të Drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtoreve, furnizim me pajisje shtesë etj.**

***10. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES - Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues:***

- Vazhdojnë vizitat për subvencione dhe grante gjatë muajit korrik në komunën e Prishtinës;
- Vazhdojnë vizitat për vlerësimin e aplikueseve për pajisje bujqësore tek fermerët e komunës së Prishtinës;
- Vizita monitoruese te fermerët përfitues të granteve, projekte të mbështetura nga Komuna e Prishtinës dhe Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA);
- Pritet të fillojë hapja e sezonit për korrje – shirje në pjesën e parë të muajit korrik;
- Do të realizohen vizita në terren lidhur me procesin e korrje - shirjeve në vitin 2019;
- Monitorimi i fermerëve gjatë kultivimit të kulturave bujqësore.

***11. TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.***